Numër:01/886
Datë: 10.09.2026

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (KD i AKK) duke vendosur për ankesën e parashtruar me datë 09.07.2026 e të pranuar në AKK me numër protokoli "ATC" Nr.01-681, datë 09.07.2026 dhe Nr.01-693, datë 16.07.2026, nga Institucioni "ATC" me adresë: Rr.Tirana, në Prishtinë, kundër vendimit të Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve Nr.01/471 të datës 29.05.2026, në mbështetje të neneve 8 dhe 9 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, nenit 20 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, si dhe nenin 5 paragrafi 8 të Rregullores Nr. 01/196 së punës të Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, me datë 10.09.2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Institucionit "ATC" Nr.01-681, datë 09.07.2026, e ushtruar kundër vendimit të Këshillit Drejtues Nr.01/471 të datës 29.05.2026.

II. Mbetet në fuqi vendimi Nr.01/471 të datës 29.05.2026 i Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve.

III. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

I. Rrjedha e procedurës :

Me datë: 09.07.2026 Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (tutje AKK) ka pranuar ankesë, me Nr.Prot. 01-681 të cilën pa humbur kohë e ka adresuar për shqyrtim tek Këshilli Drejtues (tutje KD) i AKK – së.

Këshilli Drejtues i AKK-së bazuar në kompetencat e tij ligjore, vërtetimit të gjendjes faktike dhe analizimit të provave, me datë 29.05.2026 ka nxjerr vendimin Nr.01/471 me të cilin:

- *NUK Riakreditohet dhe Rivalidohet Instituti Profesional ATC SH.P.K me adresë: Rr.UÇK, Nr.5,10.000 Prishtinë, për kualifikimet e shkurtra sipas standardeve të profesionit: Instalues Ujësjellësi dhe Kanalizimi, Niveli III i KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare Profesionale (D) me pesëmbëdhjetë (15) kredi të IAAP.*

Institucioni "ATC" i pakënaqur me vendimin e KD 01-471, të datës 29.05.2026, pas pranimit të vendimit, brenda afatit ligjore me datë 09.07.2026 ka parashtruar ankesë e cila është pranuar në Autoritetin Kombëtar të Kualifikikmeve me datë 09.07.2026 dhe është protokoluar me Nr. 01-681.

KD i AKK pas shqytimit fillestar, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë fushën e akreditimit/riakreditimi dhe validimit/rivalidimit si dhe nenin 95 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA), me datë ka ftuar për dëgjim palën ankuese, me ç'rast me datë 06.08.2026 janë dëgjuar të gjitha pretendimet ankimore dhe të gjitha shqetësimet e ankuesit.

Pas dëgjithmit të palës ankuese KD ka vlerësuar se për shkak të kompleksitetit të lëndës AKK-së dhe KD-së i duhet më shumë kohë për shqyrtimin e ankesë dhe bazuar në nenin 99 të LPPA ka njoftuar palën ankuese për shtyrjen e afatit të shqyrtimit.

II. Pretendimet e palës ankuese, ishin:

1. *Konsiderojmë se vendimi është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe procedurat administrative në fuqi, nuk mbështetet në gendjen faktike të konstatuar giatë procesit të vlerësimit dhe nuk përmban një arsyetim të plotë që do të justifikonte kundërshtlmin nga rekomandimet profesionale të grupit të ekspertëve të cal<tuar nga vetë Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.*

2. *Neni 11 dhe Neni 17 i Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 specifikon në mënyrë taksative se vendimmama e Këshillit Drejtues nuk është një akt i izoluar apo diskrecion i zhveshur nga faktet, por produkt i një procesi vlerësnni nga grupi i ekpertëve,, Ky regullim normativ dëshmon se rekomandimet e ekspertëve janë pjesë konstitutive dhe e pandashme e vendimit administrativ. Mbi bazën e Raporteve të vlerësimit për Akreditim dhe Validim të Grupeve të ekspertëve na rezulton se në të gjitha pikat e vlerësimit të tyre ne jemi vlerësuar që kalojmë plotësisht, kryesisht dhe pjesërisht, pra në asnjë nga pikat e vleresimit tö tyre ne nuk jerm vlerësuar negativisht. Rrjedhimisht, vendiml për mos akreditim është plotësisht i paligjshëm dhe në kundërshtim me rregullat e procedurës administrative. Kërkojmë man-jen në rishqyrtim të rastit tonë, shfuqizimin e tërësighëm të Vendimit Nr. 01-471, i datës 29.05.2026, si akt administrativ i paligjshëm, dhe të aprovohet Riakreditimi dhe Rivalidimi i programit "Instalues Ujësjellësi dhe Kanalizimi" të Ins.Profesional ATC.*

3. *Një veprim administrativ **nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustifikuar** nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta apo të ngjashme. Ky parim është shprehje e sigurisë juridike. Ai kërkon që organet administrative të zbatojnë standarde të njëjta për raste të njëjta, përveç kur ekziston një bazë objektive dhe ligjore që justifikon devijimin. Në rastin konkret, Këshilli Drejtues i AKK-së ka devijuar nga praktika e tij e konsoliduar administrative pa dhënë asnjë arsyetim ligjor apo faktik.*

Përgjjigje KD: Pretensimi për Shkelje të Parimeve të LPPA-së **nuk qëndron** për faktin se vendimi I KD-së është në përputhshmëri të plotë me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe të LPPA-së pas që sipas LPPA-së, thuhet, citojmë Nenin 5 Parimi i proporcionalitetit:

"1. Një veprim administrativ, që për arsye të mbrojtjes së interesit publik kufizon apo cenon të drejtat apo interesat juridike të një personi, duhet të jetë në pajtim me parimin e proporcionalitetit.
2. Një veprim administrativ është në pajtim me parimin e proporcionalitetit vetëm nëse i plotëson këto kushte:
2.1. është i domosdoshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj;
2.2. është i përshtatshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj, dhe
2.3. kufizimi apo cenimi i të drejtës apo interesit juridik nuk është në shpërpjestim me realizimin e qëllimit të ndjekur."

Në rastin konkret KD pasi ka shqyrtuar të gjitha dokumentet dhe raportet lidhur me programin/kualifikimin "Instalues Ujësjellësi dhe Kanalizimi" të Institutit Profesional ATC..., ka konstatuar se vazhdimi i një gjendje të tillë ku për **çdo riakreditim tolerohet kusht**, ky fakt bie në kundërshtim të parimit të proporcionalitetit si dhe parimin e mbrojtjes së cilësisë në arsimin profesional. Pra KD ka vlerësuar se edhe për ofruesit e kualifikimit është më mirë që ti plotësojnë të gjitha kriteret në fazën e riakreditimit dhe të mos vazhdohet me dhënien e **Riakreditimit me kushte. Pra siç është thënë** aplikimi i kushtit në procesin e riakreditimit – proces në të cilin supozohet se standardet dhe kriteret bazë janë tashmë të përmbushura nga cikli i mëparshëm – rezulton i pakuptimtë, pasi përmes kësaj humbet rëndësia e kritereve bazë të akreditimit si proces thelbësor i sigurimit të cilësisë. Po ashtu vendimi ruan pavarësinë e vendimmarrjes nga organi kolegjial vendimmarrës nga çdo lloj ndërhyrje e jashtme dhe e brendëshme, duke respektuar në thelb të gjitha parimet e LPPA-së dhe parimet e Kornizes Kombëtare të Kualifikimeve, Kornizes Europiane të Kualifikimeve si dhe mekanizmave të tjerë relevant të sigurimit të cilësisë në arsimin profesional.

4. Pretendimi i ankuesit për ushtrim të paligjshëm të diskrecionit administrativ, ku thuhet, citim: *Edhe nëse pranohet se Këshilli Drejtues ka pasur kompetencë diskrecionare për të vendosur mbi rekomandimin e Ekipit të Ekspertëve, kjo kompetencë nuk është absolute. Sipas nenit 4 paragrafi 3 të LPPA-së, pushteti diskrecionar mund të ushtrohet vetëm nëse:*

- *nuk tejkalohen kufijtë e përcaktuar me ligj;*
- *zgjedhja bëhet vetëm për të arritur qëllimin për të cilin ligji e njeh diskrecionin;*
- *respektohen parimet e përgjithshme të LPPA-së, veçanërisht parimi i proporcionalitetit; dhe*
- *vendimmarrja nuk bie në kundërshtim me normat e pranuara profesionale dhe teknike.*

➢ **Përgjigjja e KD-së:**
KD i AKK konsideron se pretendimi nuk qëndon sepse në asnjë rast nuk janë tejkaluar kufijtë e përcaktuar me ligj, akti administrativ është nxjerrë për të arritur qëllimin për të cilin ligji e njeh diskrecionin, respektohen parimet e përgjithshme të LPPA-së dhe në asnjë rast vendimmarrja nuk

bie në kundërshtim me normat e pranuara profesionale dhe teknike. Organi vendimmarrës (KD) është i përfaqësuar nga 13 anëtarë të cilët mbulojnë të gjitha institucionet dhe mekanizmat e përcaktuar me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare. KD ka vepruar brenda kompetencave dhe përgjegjësive të saj, sepse KD nuk është vetëm mekanizëm teknik për aprovimin apo mos aprovimin e kërkesave/ aplikacioneve për akreditim, por në përgjegjësinë e saj ka për obligim edhe ruajtjen e cilësisë në arsimin profesional duke zbatuar kriteret dhe duke aplikuar në mënyrë direkte standardet më të mira të cilësisë.

III. Shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;

Vendimi i atakuar Nr.01/471 të datës 29.05.2026 i Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, në të vërtetë nuk është lëshuar në arsyetime të detajuara për faktin se KD si organ vendimmarrës, nuk është i lidhur domosdoshmërisht me rekomandimin e ekipit të ekspertëve në Raportin e dorësuar dhe ka ardhur në përfundim të shpejtë se raporti i ekspertëve është bërë në kundërshtim me bazën ligjore të Riakreditimit.

KD i AKK, tutje kontaton se: Akreditimi me kusht është njohje e statusit të akreditimit me vendim, e shoqëruar me detyrimin për përmbushjen e kërkesave të caktuara brenda një periudhe të përcaktuar. Pra me rastin e vendosjes së kushtit në fazen e akreditimit **(për herë të parë) kushti ka kuptim,** ku brenda periudhës së caktuar përmbushet kushti dhe akreditimi bëhët i plotfuqishëm. Por aplikimi i kushtit edhe në riakreditim ku në këtë proces supozohet se ishte përmbushur kushti, në procesin e riakreditimit është i pakuptimt sepse humbet rëndësia e kritereve bazë të akreditimit si proces. Në mungesë të përmbushjes së plotë të kritereve të përcaktuara për riakreditim, **riakreditimi me kushte nuk përbën në vetvete kategori ligjore,** prandaj dhe vendimi paraprak nuk është lëshuar në elaborimin e arsyetimit lidhur me vlerësimin dhe komentet e dhëna në raportin e ekspertëve.

Akreditimi me kusht ka mbështetje ligjore në Udhëzim Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, **por jo edhe në fazën e Riakreditimit**.

Dhe sa i përketë pretendimit të ankuesit, se ekzistojnë raste kur është riakredituar me kusht programi/kualifikimi, konsiderojmë se edhe nëse ka ndodhur në të kaluaren është gabim që të vazhdohet tutje, është precedent i gabuar që do të zbehë aplikimin e kritereve standarde të akreditimit/riakreditimit.

IV. Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;

Mungesa e bazes ligjore që lejon riakreditimin me kusht, as në ligj e as në ndonjë akt nënligjor, fakti se nuk është paraparë në ligj si dispozitë ndaluese nuk do të dhotë që në mënyrë automatike është i lejueshëm. Pra në rastin konkret sipas të drejtës administrative **nuk vlen parimi "çfarë nuk është e ndaluar me ligj, është e lejuar."**

Bazuar në të gjitha shtjellimet e mësipërme, në pajtueshmëri me kompetencat, autorizime, diskrecionin si dhe dispozitat relevante në fuqi, Këshilli Drejtues i AKK-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj padi në Gjykatën kompetente, brenda afatit tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Hapja e Konfliktit Administrativ nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi u dërgohet:

1. "ATC"
2. Arkivit të AKK-së

Dr. Besim Mustafa

Kyetar i KD të AKK-së